

VENDIM
Nr.625, datë 21.9.2004

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE, QË DALIN TË PAPUNË, SI PASOJË E
RISTRUKTURIMIT TË SHOQËRISË “TRANSNAFTA” SHPK, PATOS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.8707, datë 1.12.2000 “Për privatizimin e shoqërisë anonime “Servcom””, të nenit 7 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, dhe të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Ministrit të Ekonomisë dhe Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e shoqërisë “Transnafta” sh.p.k., Patos, që dalin të papunë, si pasojë e ristrukturimit të kësaj shoqërie, përfitojnë pagesë për një periudhë njëvjeçare, me pagë bruto mesatare mujore të vitit të fundit të punës.

2. Periudha gjatë së cilës këto persona përfitojnë pagesën e përcaktuar në këtë vendim, t’u njihet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni pleqërie, invaliditeti e familjar dhe të shënohet në librezën e punës, sipas nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kundrejt pagesës së kontributit në fondin e sigurimit të detyrueshëm shoqëror nga “Transnafta “ sh.p.k., Patos.

3. Fondi prej 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekësh, i nevojshëm për kryerjen e kësaj pagese, të përballohet nga fitimet e vitit 2003 “ARMO” sh.a., Fier. Ky fond t’i transferohet shoqërisë “Transnafta” sh.p.k., Patos, tek e cila të kryejë çdo muaj pagesën e punonjësve, që dalin të papunë nga ristrukturimi i saj.

4. Pagesa sipas këtij vendimi ndërpritet kur përfituesit ushtrojnë veprimtari ekonomike, në formën e punësimit apo të vetëpunësimit.

5. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës, Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano